



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-3846

Dt.14.03.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Astrit (Gani) Haxhismajli – I Autorizuar sipas Autorizimit Noterial me nr. LRP.nr.1014/2016, dt.22.03.2016, nga “DEVOLLI GROUP ” Sh.P.K. me seli në Pejë**, me numër të regjistrimit të biznesit **70100453**, për dhënjen e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin – montimin e paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 17, 18, 19, 20 dhe 21, nenit 25.2 të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Planifikimin dhe Ndërtimin e objekteve në teritorin e Komunës së Gjakovës 01 Nr 011-2233 të datës 31.03.2011 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesit: **“DEVOLLI GROUP ” Sh.P.K. me seli në Pejë**, me numër të regjistrimit të biznesit **70100453**, e përfaqësuar nga **Astrit (Gani) Haxhismajli – I Autorizuar sipas Autorizimit Noterial me nr. LRP.nr. 1014/16, dt.22.03.2016, ndërtimi – montimi i paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike, me kapacitet prej 3MWh**, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Komunal, Rregulloren mbi rregullat dhe procedurat për planifikimin dhe ndërtimin e objekteve në teritorin e komunës së Gjakovës, si dhe Vendimin mbi Kushtet Ndërtimore, me nr.07-351-27022, të datës 31.01.2017, të lëshuar nga DUMM, dhe përpunuar konform dispozitave ligjore të parapara nga UA Nr.10/2013, në ngastrat kadastrale me nr. 69/9, 70/3, 70/4 dhe 71/19, Z.K. Kusar, në pronësi të “Devolli Group”SHPK (Qirambajtje 99 vite), të cilat kanë vijën e ndërtimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin – montimin e paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike në fjalë, të cilat do të shtrihen me sipërfaqe të përgjithëshme prej 6.80.75.

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi – montimi i paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike, me kapacitet prej 3MWh, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë kompania Kroate “Relatio ES “ - Varazhdin.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijave të ndërtimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsy etim

Astrit (Gani) Haxhismajli - I Autorizuar sipas Autorizimit Noterial me nr. LRP.nr. 3683/2015, dt.22.09.2015, nga "BIRRA PEJA" Sh.A. me seli në Pejë, me numër të regjistrimit të biznesit 70325365, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/02-3846 të datës 22.02.2017 për dhënjën e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin – montimin e paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike, ngastrat kadastrale me nr. 69/9, 70/3, 70/4 dhe 71/19, Z.K. Kusar, në pronësi të "Devolli Group" SHPK (Qirambajtje 99 vite), siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:3000 të datës 05.09.2016, të vërtetuar nga N.Sh.K. e M."GEO-DD"Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 28.07.2016 në pronësi të "DEVOLLI GROUP" SH.P.K. (Qirambajtje 99vite, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatat mbi të drejtën në pronë e paluajtshme me numër të lëndës 700/17, të datës 22.02.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimin me nr.07-351-27022, të datës 31.02.2017, për Kushte Ndërtimore për rregullimin e hapësirës për ndërtimin respektivisht montimin e paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike ne ngastrat kadastrale nr. 69/9, 70/3, 70/4 dhe 71/19, ZK: Kusar, të lëshuar nga DUMM.
5. Deklaratën e përbashkët për shfrytëzimin e përbashkët të hapësirave menaxhuese, të vërtetuar nga Noteri me nr. LRP.nr.507/2017, dt.07.02.2017.
6. Prokurë e Përgjithshme Noteriale me nr. LRP.nr.1014/2016, dt.22.03.2016, për përfaqësim në procedurë.
7. Deklaratën Noteriale me nr.LRP.nr.3465/2016, dt.07.07.2016, mbi shfrytezueshmerine e rrugëve private të planifikuara brenda ngastrave të kompleksit.
8. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08.zyrtarisht, mnr.08-320-01-2583, të datës 06.02.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e komunës së Gjakovës.
9. Elaborati – Studimi Gjeomekanik, "Ndërtimi i Parkut Solar" trualli Kusar, fshati Madanaj – Gjakovë, Porositës DEVOLLI GROUP - PEJE, nga "GEO – DHAME-Tirane, DHE Geomerkur" Shpk.Gjakovë.,
10. Vendimin me nr.15/6451/1-ZSP/45/16, datë 18.02.2016, mbi aprovimin e kërkesës, për pëlqimi mjedisor lidhur me projektin për ndërtimin e parkut të energjisë diellore në Kusar, nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.
11. Pëlqimin nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Departamenti i Parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit, me nr.22/17, të datës 09.02.2017.
12. Pëlqimin Sanitar, nga Inspektoriat Sanitar komunal, Drejtoria për Punë Inspektuese, me nr. 14/53/40393, të datës 12.08.2016.
13. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 1, të datës 23.02.2017.
14. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, të datës 11.08.2016.
15. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë,të datës 04.08.2016.
16. Pëlqimin nga TK-Gjakovë, me nr.36, dt.05.08.2016.
17. Vërtetimin nga K.R.M."Çabrati", nr.949 dt.08.08.2016.
18. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në "Pro Credit Bank, sipas dëshmisë se pagesës me E-Bankingë me datë 06.03.2017.
19. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, nga kompania Kroate "Relatio ES " - Varazhdin".

Taksa administrative është paguar në vlerën prej 12.264.93 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi,pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani.jur.dipl.


U.D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

KOPJE PLANI

Z.K. Kusar
Poseduesi: 1 /1 Devolli Group Sh.P.K.-Qirambajtje 99 vite

Shk. zvog. 1: 2500



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Piani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
69-9		-	Are	5	1	25	31	
70-3		-	Are	5	1	26	09	
70-4		-	Are	5	0	84	71	
71-19		-	Male	5	3	44	64	
Gjithësejtë:					6	80	75	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë, dt.28.07.2016

VËRTETON:

Arber Jusufi

Ngastra: 69-9,69-10,70-3,70-4,71-19.



Punoi : N.Sh.K e M"GEO-DD" Gjakovë
DREJTORI :
Shkelqim Brobina